

## KUMTESË PËR PUBLIKUN

Komisioni për Vendimmarrje mbi Kundërvajtjet pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në kuadër të kompetencave të tij ligjore në përputhje me Ligjin për Ndalimin e Praktikave të Padrejta Tregtare në Zinxhirin e Furnizimit me Produkte Bujqësore dhe Ushqimore, kreu inspektim në disa qendra grumbullimi që kryejnë blerjen e frutave dhe perimeve nga fermerë individualë dhe persona juridikë.

Gjatë kontrolleve të kryera, Komisioni konstatoi disa parregullsi dhe veprime në kundërshtim me dispozitat e Ligjit, veçanërisht në pjesën e rregullimit të marrëdhënieve kontraktuale ndërmjet blerësve (grumbulluesve) dhe furnitorëve të produkteve bujqësore dhe ushqimore.

Ndër parregullsitë e konstatuara janë:

- mungesa e kontratave me shkrim për blerje;
- përdorimi i kontratave që nuk përmbajnë elementet e detyrueshme të parashikuara me Ligj;
- mospërputhja e dispozitave kontraktuale me detyrimet ligjore.

Komisioni do të vazhdojë me mbikëqyrje aktive në përputhje me kompetencat e tij ligjore, me ç'rast ndaj subjekteve tek të cilat janë konstatuar parregullsi do të ndërmerren sanksionet përkatëse.

Njëkohësisht, Komisioni u bën thirrje të gjithë pjesëmarrësve në zinxhirin e furnizimit me produkte bujqësore dhe ushqimore që t'i respektojnë në mënyrë të përpiktë dispozitat ligjore, me qëllim sigurimin e marrëdhënieve afariste të drejta, transparente dhe të barabarta, si dhe mbrojtjen e fermerëve dhe furnitorëve të tjerë nga praktikatat e padrejta tregtare.